

DOKUDAILY

NUMRI I GJASHTË

EDICIONI XXIV

E MËRKURË, 6 GUSHT 2025



Rekomandime

Faqe 03

Mbi filmat

Faqe 04

DokuNights

Faqe 07

FOTO: SUER CELINA

ENDLESS GREED MENTAL VOID NUK ËSHTË THJESHT NJË KONCEPT. ËSHTË GJENDJE.

Nxiti disa mendime.

Koha lëviz me një tjetër shpejtësi nga se ecim ne. Ndihe mi si të skaduar e ndoshta kjo është arsyeja përse e kemi në ne këtë ankth të çuditshëm. Përtej asaj që ndodh në vendin, vendet tona, që shkakton ankth në shumë njerëz, megjithëse shumë të tjerë duket sikur nuk e ndiejnë. Çka na bën ne kaq të veçantë apo kaq të vlefshëm për t'u shpëtuar, në një kohë që njerëzit ndihen shumë e më shumë të zëvendësueshëm?

Përshpejtimi i kohës. Tani ndihemi sikur po i përjetojmë fantazitë e vjetra që kemi patur për të ardhmen.

Por a mundemi ne ta imagjinojmë një të ardhme.

Kam frikë ta imagjinoj një të ardhme.

Është shumë futuriste.

Jo dhe aq njerëzore.

Po çfarë është njerëzore?

Makina që fluturojnë. Robotë. Pamundësia për ta dalluar një imazh nëse është i vërtetë apo i shpikut.

E djeshmja ishte e vërtetë. E sotmja është po ashtu, e vërtetë.

Ne na duhet të imagjinojmë veten në imazhin e së ardhmes. Sepse, nëse nuk e bëjmë këtë gjë, ndoshta nuk do t'i përkasim të ardhmes.

MOS MË RRËFE TREGIME. MA TREGO NDJESINË. MË TREGO NJË IMAZH. VEÇ NJË. E ME SIGURI S'MUND TË JEMI TË VETËM.

Le të imagjinojmë.

Ka mjaftueshëm shpërqëndrime për të të mbajtur zgjuar, mjaftueshëm shpërqëndrime për të mos parë jashtë dritares së autobusit apo taksisë. Uroj që shoferët të mos shohin në telefonat e tyre, megjithëse ka mjaftueshëm aksidente për të na treguar se ata e bëjnë këtë gjë.

Pashë jashtë dritares dhe mendova në mrekullim: sa misterioz. Sa delikat dhe i fuqishëm. Trupi është fëmijë kokëfortë e gjuha një i rritur i civilizuar.

Njeriu është mjet i rëndomtë

i zhytur në të veprime të rëndomta - jo i humbur, thjesht rutinor.

Kinemaja. Një mjet moralizues që ta edukon atë besim se secili karakter transformohet në një seri të klisheve, duke reduktuar njerëz kompleksë në stereotipe e narrativa të parashikueshme për hir të të përcuari një mesazh moral.

Ka një nevojë të përvijueshme për të identifikuar, për ta menduar veten si qenie lineare, që rritemi brenda diçkaje..Por identiteti rend në udhë të përkundërt me këtë kërkesë për qëndrueshmëri. Bota ka nevoja të mëdha për të kondensim, kaos, zhvillime e përsëritje. Për mua është çelësi që të kuptoj që është e domosdoshme të mbaj mend gjëra të caktuara.

Faleminderit, Dokufest: e ke trazuar një dallgë të butë të mendimit.

Edhe njëherë, ndihem kaq pranë teje.

Më çon pas kur i kam patur gjashtëmbëdhjetë vjet,

Aty kur kinemaja mbërrite te unë, në mënyrë të vërtetë, të gjallë, të mundshme.

Ne kemi parë filma, kemi shfaqur filmat tanë,

Ndërsa e ardhmja hodhi hapat butë në mua.

Shkruar nga Norika Sefa.



REKOMANDIME

INTERNATIONAL SHORTS



SHTËPIA E KULTURËS (SALLA E MADHE) 16:00

UNWELCOMED / 70' HUMAN RIGHTS DOX




SHTËPIA E KULTURËS (SALLA E MADHE) 18:30

BRIDGING THE GAP & FUTURE IS HERE



KINOLUMI 20:00

NATIONAL



DOKUKINO PLATO 20:30

WHAT DOES IT MEAN TO WATCH? DOKUTALKS



SHKOLLA E MUZIKËS 'LORENC ANTONI' 17:00

CINNA PEYGHAMY, YAAND & URBAU DOKUNIGHTS



SONAR STAGE 22:30

MBI FILMAT

Qëndresë, heshtje dhe dashuri: Portreti intim i një familjeje nga David Bim në filmin “To the West, in Zapata”



Në edicionin e 24-të të DokuFest, shikuesit ishin të ftuar në botën intime dhe të izoluar të një familjeje kubaneze përmes lenteve bardh e zi të filmit *To the West, in Zapata* të David Bim. Pas shfaqjes pati një sesion shumë emocional të pyetjeve e përgjigjeve me regjisorin, i cili kaloi tetë vjet duke krijuar këtë histori të fuqishme e poetike.

I vendosur në moçalin Zapata në Kubë, një rezervë e largët biosfere, filmi ndjek Landi-n dhe Mercedes-in, një çift që përballat me vështirësi për tu kujdesur për djalin e tyre autik në mes të krizës ekonomike, paqëndrueshmërisë politike dhe izolimit të imponuar nga pandemia globale. Landi detyrohet të merret me gjuetinë ilegale të krokodilëve për të siguruar jetesën për familjen, shpesh duke u zhdukur për ditë me radhë në luginë, derisa Mercedes duron barrën e pasigurisë dhe vetmisë në shtëpi. Në këtë ritëm të përhershëm ndarjesh e ribashkimesh, filmi zbulon heroizmin e përditshëm dhe rimëkëmbjen e qetë të një familjeje të lidhur nga dashuria dhe të sfiduar nga mbi-jetesa.

Në sesionin e pyetjeve dhe përgjigjeve, Bim përshkroi procesin si më shumë të bazuar në heqje sesa në shtim. “Kinemaja është si skulptura”, tha ai. “Nuk shtoni, ju hiqni, derisa të arrini thelbin”. Duke punuar vetëm, gjatë gati një dekade, Bim kaloi vite as pa e ndezur kamerën; në vend të kësaj ai vëzhgonte, dëgjonte dhe priste. Rezultati është një film i ndërtuar jo vetëm mbi imazhe, por mbi prezencën, mbi një ritëm të jetës ashtu si është jetuar.

Këtë filozofi e pasqyrojnë zgjedhjet estetike të Bimit. Incizimet e qarta bardh e zi nuk janë thjesht vendim për pamjen, janë një nevojë e shndërruar në poezi. “Nuk i përballoja dot pajisjet e fuqishme, dhe bateritë ishin të vogla.

Por gjithashtu, incizimi bardh e zi më ndihmoi të krijoja një botë tjetër. Jo për të kopjuar realitetin, por për ta shprehur atë”, tha ai.

Ndoshta dimensionin më i jashtëzakonshëm i filmit *To the West, in Zapata* është sfondi zanor, të cilin Bim e krijoi me përkushtim të thellë. Me energji elektrike të kufizuar dhe pa sinjal telefoni në moçalin Zapata, ai kaloi ditë të tëra duke kapur tinguj ambien-ti, duke krijuar atë që me shaka e quan një “grumbull të çmendur prej 80 gigabajt tingujsh”. Çdo cicërimë zogjsh, zhurmë insektesh dhe puih që kalonte përmes mangrovave u seleksionuan dhe u ruajtën në një tabelë Excel, për tu përdorur më vonë për të ndërtuar një peizazh të shumëfishtë zanor, që i jep filmit forcën emocionale dhe gjeografike.

“Sfondi zanor nuk është shtuar”, theksoi Bim. “Ai i përket territorit. Reflekton jetën që Landi dhe Mercedes dëgjojnë çdo ditë”. Xhirimi i një historie kaq intime kërkonte një lloj tjetër pranie regjisoriale. “Të vendosësh kamerën mes teje dhe dikujt që e do, është dhunë”, pranoi Bim. “Kështu që i thashë Landit: xhirojmë në heshtje, si murgjit. Jemi bashkë, por pa folur”. Ky shoqërim i heshtur krijoi themelin e besimit. Sho-qërimi i Bimit me familjen ishte më i hershëm se sa filmi, ai filloi të xhironte pesë vite pas vizitës së tij të parë, dhe ajo lidhje që u ndërtua ngadalë është e prekshme në çdo kuadër.

Ai foli ndjeshëm për sfidat etike: si mund të kapësh dhimbjen e dikujt pa e shfrytëzuar atë? “Ata nuk duan të jenë heronj”, tha ai për Landin dhe Mercedesin. “Por ata janë, sepse nuk kanë zgjedhje tjetër”.

Për Bimin, *To the West, in Zapata* është më shumë se një dokumentar; është një med- itimi mbi vetë kohën.

Ai tërheq paralele me letërsinë, veçanërisht me Dostojevskin dhe Kamyn, duke vënë në dukje se në Kubë, “koha është e brishtë. Është gjithmonë një numërim mbrapsht”.

Pritja e Landit nga Mercedesi nuk është thjesht suspansë; është ekzistencë. “Dy ditë pritje mund të mos duken shumë, por për të, është një purgator. Një kohë vuajtjeje në heshtje” Ai e përmendi mitin e Sizifit—të shtysh pafundësisht një gur drejt majës, si një alegori për luftën e çiftit. “Gjëja më e keqe nuk është shtyrja e gurit,” tha ai, “është kur guri ndalon, sepse atëherë, Landi nuk është kthyer”.

Pavarësisht vështirësive të paraqitura në film, mesazhi i Bimit në fund është një mesazh shprese. “Kur nuk kemi shpresë, është gjëja më e keqe,” tha ai. “Por aktet e përditshme të dashurisë së kësaj familjeje, ushqyerja e fëmijës së tyre, mbijetesa në një dite tjetër, janë një formë rezistence”.

Dashuria e tij për Kubën ishte e prekshme, edhe pse ai e pranoi zhgënjimin e brezit të tij, shumë prej të cilëve janë larguar nga vendi. “Gjithçka nuk është humbur nëse ende ka dashuri,” përfundoi ai. “Dhe për sa kohë që jemi gjallë, ka shpresë. Dhe nëse ka shpresë, ka të ardhme.”

Shfaqja e filmit *To the West, in Zapata* në DokuFest ishte më shumë se një prezantim filmi. Ishte një përvojë e përbashkët heshtjeje, kohe dhe ndjenje të thellë njerëzore. Përmes një lenteje të vogël dhe një zemre të madhe, David Bim ofroi një udhëtim kinematografik që kalon përtej dokumentimit dhe hyn në poezi, një skulpturë në tingull dhe hije, e gdhendur gjatë tetë viteve, me durimin e dikujt që vërtet është pjesë e historisë që tregon.”

Shkruar nga Fisnik Minci

DOKUTALKS

Filma të shkurtër, sfida të mëdha: Riperciptimi i bashkëprodhimeve në Ballkan



Çfarë i duhet një filmi të shkurtër për të kapërcyer kufijtë kombëtarë në Ballkan? A është bashkëprodhimi e vetmja rrugë përpara, apo thjesht njëra nga shumë të tjera? Kjo pyetje provokuese hapi diskutimin në DokuTalk-un e këtij viti me titull Co-Produce or Stay Small, një diskutim i thellë mbi realitetet e bashkëprodhimeve rajonale dhe ndërkombëtare për filmat e shkurtër.

Më 5 gusht, në Shkollën e Muzikës "Lorenc Antoni", ky diskutim mbledhi profesionistë të filmit nga Kosova, Mali i Zi dhe Skocia për të zbërthyer ekosistemin e ndërlikuar të mjeteve të financimit, mbështetjes institucionale dhe bashkëpunimit krijues përtej kufijve.

I moderuar nga Jing Haase, bashkë-menaxhere e Short Film Forum, diskutimi nuk hezitoi të nxjerrë në pah si mundësitë ashtu edhe tensionet që i shoqërojnë bashkëprodhimet e filmave të shkurtër në rajon. Përfaqësuesja e Kosovës, regjisorja dhe anëtarja e Qendrës Kinematografike të Kosovës, Blerta Zeqiri, theksoi potencialin e madh të pashfrytëzuar dhe talentin e të rinjve në skenën filmike të vendit. Megjithatë, rruga drejt bashkëprodhimeve mbetet kryesisht e paqartë, e veçanërisht për filmat e shkurtër.

"Ne kemi financa, por kemi më shumë talente sesa para. Prandaj gjithmonë ndjejmë se kemi nevojë për më shumë. Po përpiqemi ta rrisim buxhetin çdo vit dhe kjo po ndodh, por ngadalë. Dhe kurrë nuk jemi plotësisht të kënaqur, sepse gjithmonë duam më shumë. Ne me të vërtetë besojmë se kemi shumë talente," tha Zeqiri. Edhe pse ekziston entuziazëm institucional, kornizat e strukturuar për bashkëprodhime janë ende në fazë zhvillimi. Zeqiri përmendi plane të ardhshme për krijimin e një fondi për bashkëprodhime në animacion, me synimin për të shfrytëzuar potencialin e lartë artistik që ka ky zhanër.

Sanja Jovanović nga Qendra e Filmit të Malit të Zi ofroi një perspektivë më të strukturuar: me një buxhet prej 2.5 milionë eurosh, Mali i Zi tashmë po mbështet bashkëprodhimet, përfshirë filmat e shkurtër dhe ato studentorë. Ajo theksoi se Mali i Zi këmbëngul që bashkëprodhimet të jenë organike, dhe të mos jenë të shtyra vetëm nga dëshpërimi për të qenë të financuar.

"Po, zakonisht i referohemi vendeve fqinje," shtoi ajo, "dhe mendoj se kjo lidhet kryesisht edhe me gjuhën".

Flore Cosquer nga Instituti Dokumentar Skocez theksoi se regjisorët në Mbretërinë e Bashkuar shpesh mbështeten te organizata si British Council për ta bërë të mundur realizimin e filmave të tyre.

Cosquer gjithashtu foli për programin rezidencial që kanë në bashkëpunim me DokuFest, një iniciativë që synon të promovojë shkëmbimin kulturor dhe eksperimentimin artistik mes regjisorëve skocezë dhe atyre ballkanikë.

Tutje, sesioni i pyetjeve dhe përgjigjeve me publikun kaloi në çështje më komplekse politike dhe ligjore. Pjesëmarrësit diskutuan për sfidat ligjore midis vendeve të Ballkanit dhe për mundësinë e krijimit të një brendi rajonal që do t'i ndihmonte industrisë së filmit. Zeqiri pranoi se ende ka pasiguri ligjore, por theksoi se interesat e përbashkëta artistike shpesh arrijnë të tejkalojnë pengesat burokratike.

Megjithatë, jo të gjitha bashkëprodhimet janë njësoj. Marrëdhënia e vështirë mes Kosovës dhe Serbisë, për shembull, paraqet pengesa konkrete, që nga pjesëmarrja në festivale filmi e deri te bashkëpunimi me ministritë përkatëse. "Jemi në marrëdhënie shumë të mira me të gjitha vendet e Ballkanit, dhe nuk e dimë çfarë do të na sjellë e ardhmja.

Por një gjë që mund ta them me siguri është se nuk kemi asnjë problem të punojmë me askënd", theksoi Zeqiri.

Biseda nuk i anashkaloi sfidat. Përkundrazi, Flore Cosquer theksoi se sa e rëndësishme është njohja e çështjeve ligjore, sidomos kur bashkëpunon me partnerë ndërkombëtarë. Kontratat, të drejtat e autorit dhe kontrolli krijues janë vetëm disa nga pikat që kërkojnë shumë kujdes.

"Kam parë histori shumë të dhimbshme të filmave që janë shkatërruar thjesht sepse kontratat nuk janë nënshkruar. Njerëzit punonin me miq të ngushtë dhe thonin, 'Çfarë mund të shkojë keq?' Por, ajo që mund të shkojë keq është që dikush mund të ikë me idenë tënde ose edhe më keq", theksoi ajo.

Sanja Jovanović dha këshillë të ngjashme, duke theksuar se krijuesit duhet të mendojnë me kujdes para se të nisin bashkëprodhime dhe jo ta bëjnë këtë vetëm për shkak të buxhetit.

Të bashkëprodhoni apo të punoni vetë, mesazhi ishte i thjeshtë: nuk ka një formulë të vetme që funksionon për të gjithë. Bashkëprodhimet mund të sjellin mundësi, rritje dhe dukshmëri, por vetëm nëse partnerët ndajnë më shumë me njëri-tjetrin sesa vetëm interesat financiare.

Derisa skena filmike e Ballkanit është në zhvillim e sipër, ky diskutim shërbeu si një burim frymëzimi, por edhe si një pasqyrë mbi realitetin. Për shumë krijues filmash të shkurtër, ishte një mesazh se edhe në një rajon të mbushur me kufij, bashkëpunimi kreativ gjithmonë gjen rrugën e tij.

Shkruar nga Shefket Bujari

DOKUTALKS

Përtej Heshtjes: Ku e Kalura Ende Flet



Në edicionin e 24-të të DokuFest-it, një bisedë e fuqishme u zhvillua nën moton "Përtej Heshtjes", bisedë që përballi plagët më të thella të rajonit dhe shtroi pyetjet që prej kohësh kanë mbetur pa përgjigje. E mbajtur në Shkollën e Muzikës "Lorenc Antoni", ky panel-diskutimi mbledhi zëra të shquar për të folur hapur rreth gjyqeve për krimet e luftës, kërkit të së vërtetës dhe rrugës së brishtë drejt pajtimit në Ballkanin Perëndimor.

Ky event, pjesë e programit "Përballja me të Kaluarën", synonte jo vetëm të thyejë heshtjen që e rrethon trashëgiminë e konfliktit, por edhe të amplifikojë zërat e atyre që janë prekur më së shumti.

Folës në këtë panel ishin Prof. Bella Murati, Lidija Želović dhe Veton Surroi, nën moderimin e studiuesit të filmit Sanjin Pejković. Ky diskutimi ofroi një hapësirë të rrallë ku drejtësia, kujtesa dhe shërimi u trajtuan përtej retorikës, përmes përvojës së jetuar dhe një ndershmërie të pakompromis.

Veton Surroi theksoi se e tashmja dhe e kaluara janë të lidhura ngushtë, se nuk mund të ikim apo ta harrojmë të kaluarën, sepse ajo e ka formësuar të tashmen dhe vazhdon të jetë e pranishme në të. Tutje, ai citoi shkrimtarin William Faulkner: "E kaluara nuk është kurrë e vdekur. Ajo nuk është as e kaluar."

Ai theksoi se në rajonin e Ballkanit ka shumë "konflikte të papërfunduara", dhe se ndonëse aktualisht nuk jemi në luftë, as nuk kemi arritur në paqe dhe në fakt nuk do ta arrijmë sepse jemi ende në rrugën e gabuar drejt saj. Jemi në rrugë të gabuar sepse konfliktet e vjetra nuk janë zgjidhur siç duhet, njësoj si një kockë e thyer që është shëruar gabimisht.

Profesoresha Bella Murati diskutoi faktin se si organizatat ndërkombëtare, si OKB-ja, duhet të mbajnë një pjesë të fajit për situatën aktuale në Ballkan, ku ende ekzistojnë armiqtë të forta mes shteteve dhe kulturave. "Ndërkombëtarët kanë pasur shumë pushtet, dhe ne jemi mbështetur tepër tek ata," tha ajo.

Administrimi i drejtësisë për krimet e luftës nga ana e tyre ka qenë selektiv dhe arbitrar kur është provuar, dhe në shumicën e rasteve ka munguar plotësisht" dhe këtë ajo e quajti një "bamirësi e drejtësisë." "Ata mbajnë një pjesë të përgjegjësisë për gjendjen aktuale në Ballkan", shtoi ajo.

Ajo gjithashtu theksoi se përçarjet vazhdojnë në Kosovë dhe në Ballkan sepse prindërit ua transmetojnë pikëpamjet e tyre fëmijëve, të cilët janë të rinj dhe lehtësisht të ndikuar. Ata ndihen natyrshëm të ndikuar jo vetëm nga prindërit, por edhe nga mësuesit dhe profesorët.

Lidija Želović, e lindur dhe rritur në Jugosllavi, aktualisht jeton në Holandë. Ajo u shpreh se evropianët, fatkeqësisht, janë të painformuar për Ballkanin dhe arsyet e konflikteve në këtë rajon. Ajo përforcoi pikëpamjet e shprehura nga Murati lidhur me dështimet e organizatave ndërkombëtare dhe të shteteve të fuqishme si Amerika, kur kanë tentuar të ndërmjetësojnë paqen në rajon apo ta "ruajnë paqen".

Donika Gresa

Želović, e cila ka realizuar shumë filma mbi konfliktet në Ballkan, u pyet nëse filmat mund të ndihmojnë në sjelljen e paqes. Ajo u përgjigj me një "Jo" të madhe, por shtoi se kjo nuk është arsye për të ndaluar së bërë filma.

Ajo gjithashtu vuri një pjesë të fajit mbi Evropën dhe Bashkimin Evropian, duke thënë se ata janë kudo, përpiqen, por në përgjithësi veprimet e tyre janë të gabuara dhe të dëmshme për ndërtimin e një paqeje të qëndrueshme.

Shprehja "e kaluara është prolog," nga vepra The Tempest e Shekspirit, nënvizon idenë se ngjarjet historike hedhin themelet për atë që vjen më pas. Edhe pse e kaluara nuk e përcakton të ardhmen, ajo në mënyrë të pashmangshme formëson kushtet në të cilat zhvillohet e tashmja dhe e ardhmja.

Ekziston një tension i natyrshëm midis përballjes me padrejtësitë historike dhe punës drejt pajtimit në të tashmen. Shqyrtimi i së kaluarës është thelbësor për të parandaluar përsëritjen e gabimeve të mëparshme. Megjithatë, fiksimi i tepërt i thelluar në të kaluarën mund të pengojë shkuarjen përpara. Pajtimi kërkon një përballje të singertë me historinë, por edhe aftësinë për të ecur përpara.

Një kuptim i plotë dhe i saktë i luftërave dhe konflikteve të së kaluarës është thelbësor. Pa të, shoqëritë rrezikojnë të bien në cikle të përsëritura të dhunës dhe përçarjes. Kur interpretohet me mendje të hapur, historia ka potencialin të shërbejë si një udhërrëfyes duke ndihmuar në thyerjen e modeleve të shkatërrimit dhe duke inkurajuar rrugën drejt paqes dhe bashkëjetesës.

Kjo aktivitet u mundësua përmes projektit rajonal "Mbështetja e BE-së për Ndërtimin e Besimit në Ballkanin Perëndimor", i financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe i zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

RECENSIONE

Soil and Wings (2025)



Ayten ulet në dyshtemenë e dhomës së ndenjes, familja e saj për-reth saj. Ajo është në një gjendje shpirtërore që rreket drejt filozofikes dhe po i shpjegon botën dhe jetën familjes së saj. Ata shikojnë drejt, sikur t’i kenë dëgjuar gjërat që thotë edhe më parë.

A ka vend pa punë? pyet ajo. Ajo jeton në një fermë me burrin e saj, punon më shumë se ai, kështu që është e lodhur. "Vazhdo të punosh, për ta mbajtur botën në lëvizje." Ayten ka mendime mbi temën e pirjes, konkretisht rakisë.

"Të tjerët pretendojnë se nuk duhet të pimë sepse është mëkat? Janë të gjithë gënjeshtarë. Nëse ha shumë bukë edhe ky është mëkat! Ata thonë se rakia është mëkat. Rakia, mëkat? Rakia është ilaç! Në kohën e Jugosllavisë, kishim rakinë më të mirë në botë, ilaç kaq i bukur nuk ekzistonte askund tjetër në botë."

Ajo thotë se rakia në mëngjes, me stomak bosh, shëron ulcerat, sëmundjet e zemrës, tensionin e lartë të gjakut dhe gjithashtu do t’ju mbajë larg nervozizmit. Kjo tingëllon si një ilaç i mrekullue-shëm! Rakia vjen nga rrushi, kumbullat dhe mollët, kështu që duhet të jetë e mirë për ju, arsyeton ajo. Kush mund ta kundërshtojë këtë?!

Ajo jeton në fshatin Kanatlar, Maqedoni, i njohur si shtëpia e bektashinjve, ndjekësve të Shah Haxhi Bektash Veliut, i cili lindi 800 vjet më parë. Bektashi ndërtoi një teqe (shtëpi) atje dhe burrat që iu bashkuan quhen dervishë. Filmi i tregon ata duke kënduar dhe kërcyer, si dervishë, ata janë të famshëm për këtë. Kënga thotë "ata që dehen do ta pranojnë Zotin".

Pas vaktit, Imani e udhëheq fshatin në një lutje: "Allahu na ruajttë nga fatkeqësitë dhe pikëllimet, të njohura dhe të panjohura. Lutjet tona u pranofshin nga Allahu i Madh dhe Dikmen Baba në muajin Muharrem. Unë pi në emër të Allahut! Dhe në emër të Muhamedit! Dhe në emër të Trinisë së Shenjtë, Imam Aliut!" Ajo e do shumë besimin bektashi dhe thotë: "Nuk mendoj se ka një rrugë më të pastër në këtë botë."

Ajo këndon një këngë ndërsa vajzat e reja kërcejnë një valle tradicionale. Kënga përshkruan Zotin: Ndonjëherë ngjitem në qiell, për të vëzhguar botën nga larndot, njëherë zbres në tokë, duke i lejuar botës të më vëzhgojë.

Kjo zonjë ka menduar shumë për temën e pirjes, dhe konkretisht të rakisë. "Ata që pretendojnë se nuk duhet të pimë sepse është mëkat? Janë të gjithë gënjeshtarë. Nëse secili prej jush ha shumë bukë, edhe ky është mëkat! Ata thonë se rakia është mëkat. Rakia është mëkat? Rakia është ilaç! Në kohën e Jugosllavisë, kishim rakinë më të mirë në botë, një ilaç kaq i bukur nuk ekzis-tonte askund tjetër në botë."

Ajo thotë se rakia në mëngjes, me stomak bosh, shëron ulcerat, sëmundjet e zemrës, tensionin e lartë të gjakut dhe gjithashtu do t’ju mbajë larg nervozizmit. Duket si ilaç shërues. Rakia vjen nga rrushi, kumbullat dhe mollët, kështu që duhet të jetë e mirë për ju, arsyeton ajo. Kush mund ta kundërshtojë këtë fakt?! Ajten e do jashtëzakonisht besimin bektashian; ajo thotë: "Nuk mendoj se ka një rrugë më të pastër në këtë botë."

Ajo këndon një këngë ndërsa vajzat e reja kërcejnë një valle tradicionale. Kënga përshkruan Zotin: "Ndonjëherë ngjitem në qiell, për të vëzhguar botën nga lart... ndonjëherë zbres në tokë, duke i lejuar botës të më vëzhgojë."

Ajo e drejton këngën në një këngë tjetër "Jam zier në këtë tokë të vjetër për vite me radhë. Zemër, je ende e papjekur, thanë ata". Kjo fjali, ky tekst e përmbledh gjithçka shpejt, deri në thelb. Për sa kohë që ajo jeton, do të jetë një jetë e vështirë, por në fund ajo do të jetë e pastër. Është një jetë e vështirë, por nëse dikush të quan zemër, burrë, bir, nënë, kjo të ndihmon të arrish deri në fund.

Ky film ecën mirë në portretizimin e Ayten, një zonjë myslimane Betashi e cila është një dritë për familjen dhe komunitetin e saj, duke shpërndarë mençuri dhe zgjuarsi, kokëfortë dhe me men-dime, mbretëreshë e domenit të saj.

Shkruar nga Scott Hoy

DOKUNIGHTS

Nuk mund të flas për përvojën time të performancës emocio-nuese të Ibadet Ramadanit mbrëmë pa vënë në rend atë që ndodhi pak më parë gjatë natës. Pata kënaqësinë të shihja debutimin regjisorial të Redon Kikës, "I have never been on an airplane", në Kino Lumi disa orë më parë. Filmi ndjek tre miq të ngushtë gjatë disa viteve, ndërsa ata përpiqen të largohen nga Kosova për pak kohë dhe të fluturojnë, të kufizuar nga kufizimet e rrepta të vizave. Filmi i Kikës ka një prekje politike, por motivi i tij udhëheqës është një ndjenjë e madhe dhe mbizotëruese dashurie në formën e saj më të pastër.

Dashuri romantike; dashuri platonike; dashuria si një forcë udhëheqëse, me aftësinë për t'i zhvendosur njerëzit nga të huaj të ndryshëm në miq të ngushtë në familje të pandashme. Filmi rrezatoi këtë pasion të thellë dhe, duke folur me aktorët dhe stafin para dhe pas xhirimit, ishte e qartë të shihej adhurimi i thellë që ata kishin për njëri-tjetrin dhe se si filmi i Kikës e kapi atë në të gjithë thelbin e tij. Të duash do të thotë të mësosh nga njëri-tjetri, të rritesh me njëri-tjetrin, të shijosh praninë e njëri-tjetrit.

Kjo ndjenjë dashurie që rrezatonte u përhap gjatë gjithë natës, ndërsa Ibadet Ramadani dhe grupi i saj - kitaristët virtuozë Martin Gallop dhe Tom Vastiphout - na zbukuruanmbrëmjen me këngë plot zemër të mallit, festimit, dashurisë. Duke shkuar në një drejtim tjetër energjik nga Shkodra Elektronike dy netë më parë, ky ishte një ambient më intim, hapësira e gjerë e Kalasë u kondensua në një bisedë pranë oxhakut. Ja ku ishte para nesh Ibadete Ramadani, përsëri në Kosovë ku ka kaluar fëmijërinë e saj, duke folur me turmën sikur të ishin një mik i vjetër. Së pari, ajo ia la skenën Gallop dhe Vastiphout, kitarat e tyre tingëlluese që krijonin skenën. Pastaj, kthimi në shtëpi: hyn Ramadani, buzëqeshja rrezatuese, një zë i mrekullueshëm dhe qetësues që prek thellë shpirtin.

Mbi dashurinë në të gjitha format

Ashtu si dashuria që ndanin Kika dhe miqtë e tij, kishte një ngrohtësi të njohur dhe të fuqishme midis Ramadanit dhe shokëve të saj të grupit, të tre ishin takuar në Berlin disa vite më parë - fillimi i një miqësie të bukur. Së bashku, ata performuan albumin me të njëjtin titull të Ramdanit, ku secila këngë tregonte edhe një herë një histori dashurie të dhimbshme dhe të plotë në të gjitha format e saj. Kompozimet e tyre të buta e të pakompli-kuara, të lidhura me muzikën amerikane dhe shkrimi i singertë i këngëve magjepsën, ndërsa turma përqafoi dashurinë që rreza-tonte. Kjo dashuri u shtri edhe në familje, mbesa e Ramadanit, Fiona, u ngjit në skenë dhe provoi se vokalet hyjnore mbizotëro-jnë në familje.

Drejt fundit të performancës, Gallop doli në qendër të skenës për të performuar këngën e tij të bukur "Strange Place Called Home", një histori elokuyente dhe e dëshiruar për kërkimin e një ndjenje përkatësie dhe të dashurve që e bëjnë të mundur këtë - një temë që u shfaq edhe në filmin e Kikës. Një shtëpi është një vend për t'u dashur. Një shtëpi është një vend për t'u gjetur. Shpresoj që, për një moment të shkurtër, nën yje, mbi Prizren, duke luajtur para një turme adhuruese, Ramadani dhe shokët e saj të grupit e ndjenë gjithashtu atë ndjesi familjare.

Sonte, akustika ia lë vendin dixhitales, ndërsa Cinna Peyghamy, YAAND dhe urbau hyjnë në Kalaja për një natë me kompozime që kapërcejnë kufijtë dhe marrin përsipër rreziqet, të gjitha rreth thyerjes së kufijve, duke formuar dialogë midis tradicionales dhe bashkëkohores, natyrores dhe elektronikes, melodisë dhe disondantes. Tre talente të jashtëzakonshme, tre vizione të gux-imshme dhe pa kompromis: do të shihemi atje.

Shkruar nga Gus Edgar-Chan



General Sponsor	Principal Partner	Principal Partner	Golden Sponsor
			
		 	
			
			
  		